

VENDIM
Nr.97, datë 9.2.2011

PËR MIRATIMIN E VLERËS SË KOMPENSIMIT TË DËMEVE NË KULTURAT
BUJQËSORE TË FERMERËVE TË QARKUT KORÇË, NGA PËRMBYTJET PËR
SHKAK TË RESHJEVE TË SHIUT DHE DËMTIMIT TË ARGJINATURËS SË LUMIT
DEVOLL, GJATË MUAJVE SHKURT-MARS 2010, FAZA E DYTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e vlerës së kompensimit të dëmeve të shkaktuara në kultura bujqësore, si rrjedhojë e përmbytjeve nga reshjet e shiut në komunat Libonik, Vreshtas dhe Pirg, të qarkut Korçë, në shumën 30 242 214.5 (tridhjetë milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e dyqind e katërmëdhjetë pikë pesë) lekë.

2. Miratimin e listave të familjeve të komunave të qarkut Korçë, së bashku me shumën përkatëse të kompensimit të dëmeve, sipas lidhjeve 1, 2 e 3 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Efektet që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohet këshilli i qarkut Korçë për kryerjen e pagesave për personat përfitues, sipas pikës 2 të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, këshilli i qarkut Korçës, si dhe institucioni i prefektit të qarkut Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha